REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2019:242402

Datë: 13.08.2026

Numri i dokumentit: 09288009

K.DH.SH.II.nr.1958/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ramush Bardiqi, kryetar i kolegjit, Vlora Pacolli dhe Dren Rogova, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësës "Kosovatex" SH.P.K., me NRB: 70334954, me seli në Prishtinë, rruga "Tahir Zajmi", të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Iliriana Osmani Serreqi, avokate në Prishtinë, kundër të paditurit Komuna e Prishtinës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Rina Govori, me objekt kontesti pasurim i pabazë, duke vendosur sipas ankesës së paditurit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KE.nr.161/22 të datës 07.08.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 31.07.2026, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.REFUZOHEN si e pabazuar ankesa e të paditurës Komuna e Prishtinës.

II. VËRTETOHET Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KE.nr.161/22 të datës 07.08.2024.

A r s y e t i m

Gjykata e Shkallës së Parë, me aktgjykimin e ankimuar në pikën I të dispozitivit ka aprovuar në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit "Kosovatex" SH.P.K., dhe Detyrohet i padituri Komuna e Prishtinës, që në emër të kthimit të mjeteve financiare të fituara pa bazë juridike, paditësit t'ia paguaj shumën prej 1,290.157.87 € (një milion e dyqind e nëntëdhjetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e shtatë euro e tetëdhjetë e shtatë cent), me kamatë ligjore si për mjetet e deponuara në bankat komerciale në periudhë kohore prej një viti, të llogaritur nga data e paraqitjes së padisë 30.07.2014, e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditëve, nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi. Detyrohet i padituri që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 2,835.00 € (dy mijë e tetëqind e tridhjetë e pesë euro), në afat prej 7 ditëve, nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë ka ushtruar e paditura për shkak të shkelje esenciale të dispozitave të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike

2024:343936

dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozimin që të aprovohet në tërësi ankesa e të padituërës, të prishet aktgjykimi i atakuar, dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje, apo kërkesëpadinë e paditësit te refuzoj si te pabazuar.

Paditësi ka parashtruar përgjigje në ankesë nëpërmjet të cilës ka kërkuar nga gjykata e shkallës së dytë që të refuzohet si e pathemeltë ankesa e të padituërës, ndërsa të vërtetohet në tërësi aktgjykimi i ankimuar.

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, pas vlerësimit të ankesës dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa është **e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se Paditësi "Kosovatex" SH.P.K., me datë 30.07.2014, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, ka paraqitur padi për kthimin e taksës komunale ndërtimore, kundër të padituri Komuna e Prishtinës, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri që paditësit t'ia kthej shumën prej 1,290.928.47 €, të paguara në emër të taksës ndërtimore për moslejimin e realizimit të projektit, së bashku me kamatën ligjore sipas normave të kamatës së bankave komerciale, nga dita e kryerjes së pagesave e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore. Në seancën e datës 14.01.2019 e autorizuara e paditësit ka bërë plotësimin e padisë duke deklaruar se e njëjta është ushtruar në emër të pasurimit të pa bazë sipas nenit 210 par.4 të LMD-së. Ndërsa në fjalën përfundimtare e autorizuara e paditësit ka kërkuar që të detyrohet i padituri që në emër të pasurimit të pabazë, nga taksa administrative për leje ndërtimore, t'ia kthej paditësit shumën prej 1,290.157.87 €, së bashku me kamatën ligjore nga dita e ushtrimit të padisë.

Përfaqësuesi i autorizuar i të padituri me përgjigje në padi, gjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, pasi që e njëjta nuk është mbështetur në asnjë dispozitë ligjore e cila do të vërtetonte se i padituri është pasuruar pabazë siç pretendon paditësi. Gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e ka aprovuar t kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Tutje, Gjykata ka theksuar se në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësi ka qenë i pajisur me Leje Urbanistike të lëshuar nga Komuna e Prishtinës për ndërtimin e objektit në ngastrën kadastrale nr.2876 dhe 2877 e evidentuar në fletën poseduese nr.11723, KK Prishtinë, e po ashtu nuk ishte kontestues as fakti se sipas Konkluzës së lëshuar nga Komuna e Prishtinës me numër 05-351-23084 e datës 18.07.2012, është vazhduar afati i vlefshmërisë së lejes ndërtimore nr.05-351-3848 të datës 04.04.2009. Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues as fakti se paditësi ka bërë pagesën e taksës administrative për leje ndërtimore në shumën prej 1,290.157.87 €, të përcaktuar me Aktvendimin e Komunës së

2024:343936

Prishtinës me numër 05NR.351-3848 të datës 26.02.2009. Në rastin konkret kontestues ndërmjet palëve ndërgjyqëse ishte nëse paditësit i takon e drejta për kthimin e mjeteve të paguara në emër të taksave administrative për leje ndërtimore, përkatësisht nëse ekziston baza ligjore për mbajtjen e shumës së paguar në emër të taksës administrative për lejimin e ndërtimit, nga ana e të padituri. Meqenëse baza juridike mbi të cilën paditësi ka realizuar pagesën dhe i padituri ka pranuar të njëjtën, nuk është realizuar përkatësisht, kjo e drejtë për ndërtim e krijuar në bazë të lejes ndërtimore, është hequr me Vendimin e Komunës së Prishtinës 09Nr.356-139791 të datës 09.06.2014, për ndërprerjen e punimeve të filluara nga paditësi, për shkak të mungesës së lejes përkatëse, gjykata vlerëson se nuk ka asnjë bazë juridike për mbajtjen e atij kompensimi, andaj si rrjedhojë në rastin konkret i padituri është pasuruar pa bazë në dëm të paditësit.

Gjykata Komerciale, Dhoma e Shkallës së Dytë si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkalles së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës ankuese për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore ngase kjo gjykatë vlerëson se dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është mjaft i qartë, në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye edhe për besueshmërinë e mjeteve provuese me të cilat ka vërtetuar faktet kontestuese si dhe ka dhënë shpjegime të mjaftueshme për mënyrën e kualifikimit të fakteve në raport me normat materialo-juridike të cilat janë zbatuar në rastin konkret. Kronologjia e arsyetimit të vendimit sipas vlerësimit të Gjykatës Komerciale–Dhomat e Shkallës së Dytë paraqet një përmbajtje koherente, unike dhe logjike për përfundimin ligjor lidhur me themelësinë e kërkesës.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të autorizuarit të paditësit se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ngase Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, konstaton se gjykata **e** shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, me provat e administruara e te cilat i pranon edhe Kolegji i kësaj gjykate, për arsye se, në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar dhe provave të administruara në këtë çështje juridike kontestimore, gjykata e shkalles e pare ka ardhur në përfundim, se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar. Se këndejmi nga provat e administruara që gjenden në shkresat e lëndës, gjykata gjeti se paditësi sipas kërkesës së parashtruar me datën 16.06.2008 ka marr Lejen Urbanistike me nr. 05NR.350-1213/1, të datës 01.08.2008, me të cilën janë përcaktuar kushtet Urbanistike – Teknike për ndërtimin e objektit banesor kolektiv me afarizëm, në ngastrën kadastrale nr.2876 dhe 2877, e evidentuar në fletën poseduese nr.11723, KK Prishtinë, sipas Planit Rregullues të lagjes “Kalabria” në Prishtinë. I padituri sipas Aktvendimit me numër 05NR.351-3848 të datës 26.02.2009, i ka caktuar parashtruesit të kërkesës këtu

2024:343936

paditësit, që në emër të kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore, për ndërtimin e objektit afarist dhe administrativ, sipas lejes ndërtimore 05Nr.351-3848, në ngastrën kadastrale nr.2876 dhe 2877 të evidentuar në fletën poseduese nr.11723, Komuna Kadastrale e Prishtinës, të paguaj shumën prej 1,290.157.87 €. Paditësi me datë 26.02.2009 ka kryer pagesën në shumën prej 387,047.36 €, me datë 30.06.2010 ka kryer pagesën në shumën prej 645,078.93 € dhe me datë 24.11.2011 ka kryer pagesën në shumën prej 258,031.57 €. Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues as fakti se paditësi ka bërë pagesën e taksës administrative për leje ndërtimore në shumën prej 1,290.157.87 €, të përcaktuar me Aktvendimin e Komunës së Prishtinës me numër 05NR.351-3848 të datës 26.02.2009. Gjykata e shkallës së parë nga provat e administruara, ka konstatuar së paditësi ka provuar se me datë 06.06.2014 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me përgjigjen e dhënë në ankesë me numër 155/14, ka vlerësuar se informimi me nr.05-351-6108, datë 08.04.2014, nuk është akt administrativ konform Ligjit për Procedurën Administrative dhe se sipas dispozitave ligjore një akt administrativ prodhon efekte juridike nga data e marrjes së atij akti jo nga dita e nxjerrjes së tij dhe ka konstatuar se konkluzioni nr.05-351-23084 datë 18.07.2012, është pranuar nga pala me datë 01.07.2013, dhe organit të shkallës së parë i ka rekomanduar që në afat prej 7 ditësh të zhvilloj procedurën administrative dhe të nxjerrë aktin administrativ sipas dispozitave të nenit 82, 83, 84, 85 dhe 86 të Ligjit për Procedurën Administrative Nr.02/L-28. Me datë 09.06.2014 Komuna e Prishtinës, Drejtoria e Inspekcionit, Sektori i Ndërtimit me Vendimin 09 Nr.356-139791, ka urdhëruar paditësin për ndërprerjen e menjëhershme të punimeve në objektin e ndërtuar në Prishtinë, Lagjja Kalabri, rruga Tahir Zajmi, pasi që pas kontrollës së bërë nga Inspekcioni i Ndërtimit i Drejtorisë së Inspekcionit të Komunës së Prishtinës me datë 06.06.2014, është konstatuar se i njëjti ka filluar gërmimin e terrenit, pa sigurimin e lejes përkatëse nga organi kompetent komunal. Me datë 19.06.2014 paditësi njofton palën e paditur për ndërprerjen e punëve sipas vendimit të Komunës së Prishtinës dhe kërkon kthimin e mjeteve të paguara në emër të taksave komunale, ndërsa me datë 07.07.2014, paraqet përsëri kërkesën për ndërmarrjen e veprimeve nga i padituri.

Sipas nenit 90 të Ligjit Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative përcaktohet se: *"90.1. Aktet administrative individuale dhe kolektive iu dërgohen palëve të interesuara në afat prej 30 ditësh."* Me dispozitën e nenit 109 të Ligjit Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative është përcaktuar: "*Palët e interesuara duhet të njoftohen për të gjitha aktet administrative me anë të të cilave: a). merren vendime lidhur me pretendimet e tyre; b). caktohen detyrime dhe dënime ose shkaktohen dëme; c). krijohen, marrin fund, zgjerohen ose kufizohen interesa legjitime ose të drejta të palëve, ose pengohen kushtet për gëzimin e tyre në ndonjë mënyrë tjetër."* ndërsa me nenin 112 të këtij ligji përcaktohet: "*Aktet administrative duhet të njoftohen brenda tetë ditëve nga dita kur është nxjerrë, akti me përjashtim të rasteve kur me ligj është paraparë afat tjetër.' Andaj b*azuar në dispozitat e mësipërme rezulton se për aktet administrative me të cilat vendoset për kërkesat e palëve dhe në cilëndo mënyrë ndikojnë në të drejtën e palës, palët duhet të njoftohen për aktin administrativ brenda afatit prej tetë ditëve, në ndonjërën nga mënyrat e përcaktuara në nenin 113 të Ligjit Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, ndërsa të njëjtat duhet të u dërgohen palëve në afat prej 30 ditësh. Në rastin konkret rezulton se paditësi lidhur me vendimin për vazhdimin e vlefshmërisë së lejes së ndërtimit, përkatësisht Konkluzën me numër 05-351-23084 e datës 18.07.2012, është njoftuar me datë 01.07.2013, kur ka pranuar të njëjtën, ndërsa në shkresat e lëndës nuk ka asnjë provë me të cilën do të mund të vërtetohej se

2024:343936

paditësi është njoftuar për këtë vendim në ndonjë mënyrë tjetër, e për më tepër ky fakt nuk është kontestuar as nga vet i padituri. Andaj meqenëse Konkluza me të cilën është vazhduar afati i lejes së ndërtimit është pranuar nga paditësi me datë 01.07.2013, rezulton e njëjta ka filluar të prodhoj efekt ndaj palës paditëse nga data në të cilën është njoftuar për aktin dhe jo nga data e nxjerrjes së tij, sepse dështimi i të padituri për njoftimin e paditësit lidhur me aktin e nxjerrë dhe dërgimi i të njëjtit afërsisht një vit pas nxjerrjes së tij, në asnjë mënyrë nuk mund të ketë pasoja dhe të ndikoj negativisht në të drejtat e palës tjetër, në këtë rast paditësit dhe i njëjti nuk mund të mbahet përgjegjës për mos zbatimin e vendimit për të cilin nuk ka qenë në dijeni se ekziston.

Gjykata e shkalles se dytë analizoi pretendimet e padituri ne lidhje me afatin e punimeve, dhe vlerëson se sipas dispozitave te neni 48 par.1 të Ligjit për Ndërtimin Nr.2004/15, më të cilin përcaktohet se:" *Leja e ndërtimit pushon së vlejturi nëse punët ndërtimore për të cilat leja e ndërtimit është dhënë, nuk fillojnë në afatin prej 2 vitesh, nga dita e lëshimit të lejes së ndërtimit, apo nëse punët rreth ndërtimit ndërpriten për periudhë prej një viti kur skadon leja e ndërtimit për ndërtim parcial"*. Po ashtu dispozitat e nenit 21 par. 6 dhe 7 të Ligjit për Ndërtimin Nr. 04/L – 110, të cilat përcaktojnë se:" *6. Leja ndërtimore pushon së vlejturi nëse aplikuesi nuk fillon ndërtimin në afatin prej një (1) viti nga dita e fuqizimit të lejes ndërtimore" dhe "7. Vlefshmëria e lejes ndërtimore mund të zgjatet me kërkesën e aplikuesit për një (1) vit"*, gjeti se një pretendim i tillë është i paqëndrueshëm**.** Kolegji i kësaj gjykate pranon vlersimet e gjykatës s e shkalles e pare se Sipas dispozitave te lartecekura rezulton se afati kohor i përcaktuar në lejen e ndërtimit paraqet kusht vetëm për fillimin e ndërtimit, ndërsa në rastin konkret nga provat e administruara, përkatësisht nga Procesverbali për kontrollin inspektues me numër 09.NR.356 i datës 06.06.2014, me të cilin është konstatuar se është filluar me mihjen e bodrumit pa e siguruar lejen e ndërtimit, rezulton se paditësi ka respektuar në tërësi afatin kohor për fillimin e punimeve sipas lejes së vazhduar me Konkluzën me numër 05-351-23084 të datës 18.07.2012, të pranuar me datë 01.07.2013 dhe se i njëjti brenda kësaj periudhe kohore ka ndërmarrë veprime dhe ka filluar punimet sipas lejes se lartshënuar.

Edhe kolegji i kësaj gjykate aprovoj konstatimet faktike të Gjykatës se shkallës se pare, e cila vërtetoi se përkundër faktit se i padituri ka lëshuar lejen dhe ka vazhduar kohëzgjatjen e saj edhe për një vit, e po ashtu ka pranuar kompensimin në emër të lejes ndërtimore 05Nr.351-3848, i njëjti duke u bazuar në konstatimet e bëra në Procesverbalin për kontrollin inspektues me numër 09.Nr.356 të datës 06.06.2014, sipas të cilave është konstatuar se fillimi i punimeve me mihjen e bodrumit është bërë pa u siguruar leja e ndërtimit, meqenëse lejes ekzistuese 05-351-3848 i ka kaluar afati, i padituri ka marrë Vendimin 09NR.356-139791 të datës 09.06.2014, dhe ka urdhëruar paditësin për ndërprerjen e punimeve nën pretendimin se nuk ka siguruar lejen përkatëse nga organi kompetent komunal. Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të autorizuarit të palës se padituresë për gjendjen faktike të konstatuara, pasi që të njëjtat pretendime janë të paargumentuar dhe të njëjtat në rastin konkret mbesin vetëm pretendime të natyrës deklarative dhe jo relevante për të vendosur ndryshe si është vendosur me aktgjykimin e ankimuar.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale pasi me në bazë të dispozitës së nenit 210 par.4 të LMD-së, me të cilin përcaktohet: *"Detyrimi i kthimit, respektivisht i kompensimit të vlerës, fillon edhe kur diçka merret duke marrë parasysh*

2024:343936

bazën që nuk është realizuar ose që është hequr më vonë", ka për detyrim t'ia kthejë paditësit.". Në rastin konkret edhe kolegji i kësaj gjykate vlerëson se gjykata shkalles se pare drejt ka vendosur kur ka aprovua padinë e paditësit për arsye se, i padituri me vendimin e lartcekur ka ndërprerë punimet e filluara bazuar në lejen ndërtimore të lëshuar nga vet i padituri dhe për të cilën ka pranuar kompensimin, rezulton se i padituri me këtë vendim i ka pamundësuar paditësit kryerjen e punëve për realizmin e projektit në përputhje me qëllimin e kompensimit, e për më tepër nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në lidhje me kërkesën e paditësit, duke mbajtur edhe kompensimin e pranuar mbi bazën e lejes ndërtimore. Meqenëse leja për të cilën i padituri ka caktuar kompensimin nuk është vazhduar dhe nga vet i padituri është konstatuar se punimet e filluara nga paditësi duhet të ndërpriten menjëherë, rezulton se në rastin konkret ka rënë baza juridike për mbajtjen e mjeteve nga i padituri, të pranuara në emër të atij kompensimi dhe është krijuar marrëdhënia detyrimore mes personit të pasuruar dhe të varfëruar, ashtu që personi i pasuruar (këtu i padituri) është i detyruar t'ia kthejë personit të varfëruar (këtu paditësi), atë që ka pranuar pa bazë juridike.

Po ashtu kjo gjykatë e pranon qëndrimin juridik te gjykatëse së shkalles e pare sa i përket parashkrimit të kërkesës se ne rastin konkret gjen zbatim dispozita e nenit 371 të LMD-së, i cili parasheh afatin 10 vjeçar të parashkrimit, ndërsa në rastin konkret paditësi ka realizuar pagesën e mjeteve në emër të taksës administrative për lejen ndërtimore në tre këste dhe atë me datë 26.02.2009; 30.06.2010 dhe me datë 24.11.2011, ndërsa padia e paditësit është paraqitur me datë 30.07.2014, pra pa kaluar afati prej 10 vitesh i përcaktuar në dispozitën e lartcekur. Gjykata ka marrë këtë qëndrim juridik sepse në këtë çështje juridike aplikohet neni 34 i Ligjit mbi ndryshimet dhe plotësimet mbi marrëdhëniet detyrimore "Fletorja zyrtare e RFJ nr. 3l/93 i dt. l8.06 l993" i cili ka hy në fuqi me 25.06 l993, me të cilën është parashikuar se në nenin 371 të LMD fjala "pesë" zëvendësohet me fjalën "dhjetë" respektivisht në bazë të kësaj dispozite kërkesat parashkruhen për dhjetë vite, nëse me ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër i parashkrimit. Gjykata po ashtu e vlerësoi si të paqëndrueshëm pretendimin e të paditurit se në rastin konkret paditësi ka bërë ndryshimin e padisë nga neni 257 par. 1 i LPK-së, sepse në fillim ka kërkuar kthimin e mjeteve në shumën prej 1,290.928.47 €, në emër të taksave ndërtimore për moslejimin e realizimit të projektit ndërsa me plotësimin e padisë ka deklaruar se padia ushtrohet nga baza e pasurimit të pabazë, sepse bazuar në nenin 257 të LPK-së me të cilin përcaktohet se: "*1. Ndryshim të padisë përbënë ndryshimi i njëjtësisë së kërkesëpadisë, zmadhimi i kërkesëpadisë apo parashtrimi edhe i një kërkese tjetër krahas asaj ekzistuese. 2. Padia nuk quhet e ndryshuar po që se paditësi e ka ndryshuar bazën juridike të kërkesëpadisë, po që se e ka zvogëluar kërkesëpadinë, apo po që se i ka ndryshuar, plotësuar apo përmirësuar, thëniet e caktuara në padi."*, ndryshimi i bazës juridike të padisë nuk përbën ndryshim të padisë.

Andaj, gjykata pretendimet ne ankese nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga ana e gjykatës se shkalles e pare. Gjykata nuk ka mundur ti marr parasysh pretendimet e ankuesit, pasi qe sipas konstatimeve te lartecekuar pretendimet e paditurës janë tërësisht të pa qëndrueshëm dhe të pa mbështetur në prova materiale, njashtu janë shumë kontradiktor në vetvete dhe në raport me provat e prezantuar, si dhe me bazën ligjore në fuqi, sepse paditësi nuk ka qenë të gjendje të provojë përmes ndonjë dëshmie me të cilin do të argumentohej te kundërtën e konstatimeve te dhëna ne

2024:343936

aktgjykimin e atakuar. Pretendimet ankimore për vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë nuk i ka pranuar, pasi që me provat e administruara në këtë çështje juridike kontestuese gjykata e shkallës së parë i ka vërtetuar të gjitha faktet vendimtare mbi bazën e të cilave ka vendosur për aprovimin të kërkesëpadisë.

Gjendja faktike në këtë çështje juridike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, për çka nuk qëndrojnë pretendimet ankimore, për arsye se, gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Sipas kolegjit të kësaj gjykate gjendja faktike në këtë procedurë është konstatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë. Në këtë kuptim vlerësimet që ka dhënë gjykata e shkallës së parë për vlerën provuese dhe besueshmërinë e provave të administruara nga ana e gjykatës së shkallës së parë, i pranon si të tilla edhe Kolegji, për të cilën ky është përfundim i drejtë dhe i pranueshëm. Ne përfundim pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, kolegji vlerëson se aktgjykimi i shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Vendimin lidhur me rrjedhjen e kamatëvonesës është bazuar në dispozitën e nenit 214 të LMD-së, e cila përcakton se " *Kur kthehet ajo që është fituar pa bazë, duhet të kthehen frutat dhe të paguhet kamatëvonesa, e pikërisht, në qoftë se fituesi është i pandërgjegjshëm, që nga dita e fitimit, e përndryshe që nga dita e paraqitjes së kërkesës*", meqenëse në rastin konkret, i padituri pagesën e shumës për taksës administrative për lejen e ndërtimin, e ka pranuar mbi bazën e Aktvendimit me numër 05Nr.351-3848 i datës 26.02.2009, në emër të kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore, për ndërtimin e objektit afarist dhe administrativ, sipas lejes ndërtimore 05Nr.351-3848, andaj vendosi që kamatëvonesa të aplikohet që nga dita e paraqitjes së padisë, konkretisht me datë 30.07.2014, ndërsa sa i përket lartësisë së kamatës ligjore, gjykata vendosi në kuptim të nenit 277 të LMD-së. Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërthënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e shkallës së Dytë.

Nga arsyet e cekura Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194,195 paragrafi 1, pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.1958/24 me datë 31.07.2026

Kryetari i Kolegjit, gjyqtari
Ramush Bardiqi

2024:343936